

NJOFTIM PUNËSIMI	
Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për <u>një vend pune</u>: Inspektor pranë Sektorit Menaxhimit Debive në Njësinë Operative Durrës nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri evidenton dhe raporton mbi gjendjen e matësve si mungesa e vulave, ndërhyrje të paligjshme dhe të pa autorizuar në matës, probleme funksionale të matësit, etj.
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	• Evidenton dhe raporton mbi konsumatorët pa matëse. • Evidenton dhe raporton për mospërputhje të leximit në sistem me atë faktik, kur i kërkohet. • Evidenton dhe raporton mbi moszbatimin e detyrave nga punonjës të tjerë, sa i përket lidhjeve në rrjet. • Evidenton dhe raporton mbi moszbatimin e ligjshmërisë dhe/në lidhje me konsumatorin. • Evidenton dhe raporton çdo lloj forme abuzimi në rrjetin furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. • Kryen njoftimet përkatëse të klientëve debitor sipas listave të dërguara nga Sektori i Menaxhimit Debive pranë Drejtorisë së Përgjithshme dhe mban përgjegjësi personale për moszbatimin në kohë të njoftimeve. • Kryen verifikime sipas udhëzimeve të Drejtuesit Grupit. • Mbështet dhe merr pjesë aktivisht në kryerjen e inspektimeve nga Drejtoria e UPA e Drejtorisë së

	Përgjithshme duke u vënë në dispozicion të saj si dhe duke zbatuar udhëzimet e saj. • Mbështet dhe merr pjesë aktivisht në të gjitha fushatat e ndërgjegjësimit për zbatimin e detyrimeve ligjore të konsumatorëve ndaj Shoqërisë dhe në plotësimin e Formularëve për përditësimin e të dhënave të konsumatorëve. • Përfshihet në mënyrë aktive në sqarimin e ankesave të konsumatorëve, duke bashkërenduar me strukturat e Degës së Shitjes në NjO, si dhe Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë së Shërbimit të Klientit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe duke zbatuar udhëzimet e tyre.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	• Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 21.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.	